Ndërtim i rrugës së varrezave "Beltojë"	2017	450	500
Ndërtim i rrugës "Malësorët e Mullirit"	2018	360	150
Ndërtim i rrugës Gjergj Jakin, Bërdicë e Sipërme,	2018	670	680
Ndërtim i rrugës së Palokajve, Bërdicë e Madhe	2018	650	800
Sistemim - asfaltim i rrugës Bërdicë e Sipërme (Rruga e Shkollës)	2019	280	200
Sistemim - asfaltim i rrugës "Mollojsve", Bërdicë e Sipërme	2019	470	200
Sistemim - asfaltim i rrugës së varrezave të Fshatit Mali –Hëbaj	2019	680	800
Sistemim - asfaltim i rrugës "Ramoshaj", Trush	2019 - 2020	780	2000
Sistemim - asfaltim i rrugës së varrezave në fshatin Bërdicë e Mesme	2020	900	900
Sistemim - asfaltim i rrugës së "Xhurretëve" në fshatin Trush	2020 - 2021	650	1000
Sistemim - asfaltim i rrugës Bërdicë e Mesme - rrugë nacionale Velipojë	2020	300	250
Sistemim - asfaltim i rrugës së "Përroit" Beltojë	2020	280	500
Sistemim – Asfaltim blloku qendër "Bërdicë e Madhe"	2020	380	120
në proces: sistemim - asfaltim degëzim i rrugës "Gjomarkaj"	2021	160	120
në proces: vazhdim i rrugës së Ramoshve (Lagja Peraj)	2021	780	800
në proces: Sistemim - Asfaltim i Rrugës Muhaj-Nj.A. Bërdicë	2021	400	600
në proces: sistemim - asfaltim i rrugës "Mehaj"	2021	380	250

Dajç

INFRASTRUKTURA RRUGORE	vitet e realizimit	ml	banorë përfitues
Rikonstruksion i rrugës së Shirqit	2016	1000	1030
Rikonstruksion i rrugës së Mushanit Segmenti I	2017	700	250
Sistemim - asfaltim: Rrugë të brendshme të fshatit "Samrisht i Vjetër" Faza I & II	2019-2021	1630	1339
Sistemim - asfaltim: Rruga e "Dajçit të Ri" (Shkolla e Mesme Dajç)	2019	700	1000
Sistemim - asfaltim: Rruga "Rragame" Juban, Loti 1	2020-2021	600	1000
Sistemim - asfaltim: Rruga "Pentar i Poshtëm"	2020 - 2021	1100	600
Sistemim - asfaltim: Rruga Darragjat	2020	1900	9077
TOTAL		7630	18395
PROJEKTIM			
Në proces: Sistemim asfaltim rruga "Mandajve	2021	810	2430
Në proces: Sistemim asfaltim rruga e Fshatit Shirq	2021	1290	1030
Në proces: Sistemim asfaltim i rrugëve të brendshme fshati Shirq (rruga e Kishës së Shirqit, rruga e Mirukve)	2021	1000	1030
Në proces: Sistemi asfaltim Rruga e Mushanit Loti II	2021	370	250
Në proces: Rruga "Mali i Gjymtit", Dajç	2021	2000	200

Guri i Zi

INFRASTRUKTURA RRUGORE	vitet e realizimit	ml	banorë përfitues
Mirëmbajtje e rrugëve (riparim asfalti, çakull, prerje shkurre dhe bimësi dëmtuese) në rrugët ekzistuese:			
Vukatanë - Guri i Zi		1800	
Guri i Zi - Rragam		4000	
Rrugët e brendshme të fshatit Juban		7000	
Rruga e Kuçit		3000	
Rruga Kuç - Vukatanë		4300	
TOTAL		20100	11000
Ndërtimi i rrugës Rragam - Sheldi	2017-2020	4600	2000
Ndërtimi i rrugës përmes fshatit Ganjollë	2017	600	600
Ndërtimi i rrugës së lagjes Corraj, fshati Guri i Zi	2018-2019	600	2000
Ndërtimi i rrugës së Xhamisë, fshati Guri i Zi	2018-2019	420	2000
Sistemim - asfaltim i rrugës "Rragame " Juban	2020-2021	600	1000
Sistemim - asfaltim i rrugës Vukatanë - Gur i Kuq, Juban Loti I	2020	750	5000
Sistemim - asfaltim i rrugës së Kishës së Rragamit	2020	150	2000
Në proces: Sistemim - asfaltim i rrugës Vukatanë - Gur i Kuq, Juban Loti II	2021	825	5000
Në proces: Sistemim - asfaltim i rrugës së Gështenjave, fshati Rrenc	2021	600	100
TOTAL		9145	19700
PROJEKTIM			
Në proces projektimi: Sistemim - asfaltim i rrugës "Balzaj"	2021	600	800
Në proces projektimi: Sistemim - asfaltim i rrugës "Damnore", në fshatin Rrenc	2021	700	800
Në proces projektimi: Sistemim - asfaltim rruga e lagjes "Grenas", në fshatin	2021	600	200
Në proces projektimi: Sistemim - asfaltim i rrugës përmes fshatit Juban	2021	4700	3000
Në proces projektimi: rruga e lagjes Kovaç, fshati Ganjollë	2021	600	600
Në proces projektimi: rruga e fshatit Mazrek	2021	300	500

Postribë

INFRASTRUKTURA RRUGORE	vitet e realizimit	ml	banorë përfitues
Shërbime riparimi të akseve të rrugëve rurale: Fermentim Ura e Mesit – Muri i Turkut	2017	300	1000
Sistemim asfaltim rruga qendër Mes - Qendër Dragoc	2017	500	150
Sistemim asfaltim rruga "Ura e mesit-Drisht".	2020-2021	2700	800
Sistemim asfaltim rruga "Fshat i Ri - Dragoç"	2019	1800	240
Sistemim asfaltim rruga Qendër Mes – Kullaj	2020-2021	4500	750
Sistemim asfaltim rruga Boks - Ura e Rrasekut	2020	1300	500
Sistemim asfaltim rruga Qendër Boks – Ura e Mesit	2020	380	200
Sistemim asfaltim rruga Kullaj – Kullaj Sukë	2020	900	150

Qytet lagje 1

INFRASTRUKTURA RRUGORE	vitet e realizimit	ml/m2	banorë përfitues
Rikualifikim i blloqeve të banimit		m2	
Rikonstruksion i bllokut të pallateve rruga "Osja Falltores"	2017	1250	250
Rikualifikim urban i bllokut të banimit "Bulevardi Zogu I" (Xhabije)	2018	1950	380
Rikonstruksion i bllokut të pallateve "Osja I Falltores" (krahu i majtë)	2020	430	200
Rikualifikim urban i bllokut të banimit "Bulevardi Zogu i Parë" (Pas Furrës së bukës "Hysaj")	2020	500	300
Total		4130	1130
RIKUALIFIKIM RRUGË DHE TROTUARE	vitet e realizimit	ml	banorë përfitues
Rikonstruksion rruga Degëzim "Isuf Sokoli"	2016	300	100
Rikonstruksion rruga "Qazim Llazani";	2016	300	80
Rikonstruksion rruga "Sami Repishti"	2017	500	280
Rikonstruksion rruga "Bashej"	2018	300	120
Rikonstruksion rruga "Kacelej"	2018	250	60
Rikonstruksion rruga "Drishtej"	2018	100	150
Rikonstruksion rruga "Rozar Dodmasej"	2018	260	100
Rikonstruksion rruga Mukej	2019	60	50
Rikonstruksion rruga Udhakryq	2019	1000	400
Rikonstruksion rruga Cen Broja	2019	190	80
Rikonstruksion rruga Bahçallek	2019	480	300
Rikonstruksion degëzime rruga e "Shirokës"	2019	465	400
Rikonstruksion rruga "Vehbi Ismaili"	2019	225	110
Rikonstruksion rruga "Safet Hoxha"	2020-2021	135	120
Rikonstruksion degëzim rruga "Ibrahim Rugova"	2020-2021	70	50
Rikonstruksion Rruga "Daniel Mozali"	2020-2021	520	200
Rikonstruksion degëzim Rruga "Hamz Kazazi"	2020	115	130
Rikonstruksion Rruga "Rexhep Dizdari"	2020	100	120
Ndërtim trotuari rruga nacionale (rruga e Tiranës), Bahçallek	2020	1000	300
Rikonstruksion rrugë të brëndshme "Shirokë"	2020 - 2021	150	200
Në proces: Sistemim - asfaltim rruga "e Drinit" Bahçallek	2021 - 2023	300	70
Në proces: Rikonstruksion rruga "Freskej"	2021 - 2023	100	100
Total		6920	3520

Lagje 2

INFRASTRUKTURA RRUGORE	vitet e realizimit	ml/m2	banorë përfitues
Rikualifikim i blloqeve të banimit		m2	
Rikonstruksion i bllokut të pallateve rruga "Osja Falltores"	2017	1250	250
Rikualifikim urban i bllokut të banimit "Bulevardi Zogu I" (Xhabije)	2018	1950	380
Rikonstruksion i bllokut të pallateve "Osja I Falltores" (krahu i majtë)	2020	430	200
Rikualifikim urban i bllokut të banimit "Bulevardi Zogu i Parë" (Pas Furrës së bukës "Hysaj")	2020	500	300
Total		4130	1130
RIKUALIFIKIM RRUGË DHE TROTUARE	vitet e realizimit	ml	banorë përfitues
Rikonstruksion rruga Degëzim "Isuf Sokoli"	2016	300	100
Rikonstruksion rruga "Qazim Llazani";	2016	300	80
Rikonstruksion rruga "Sami Repishti"	2017	500	280
Rikonstruksion rruga "Bashej"	2018	300	120
Rikonstruksion rruga "Kacelej"	2018	250	60
Rikonstruksion rruga "Drishtej"	2018	100	150
Rikonstruksion rruga "Rozar Dodmasej"	2018	260	100
Rikonstruksion rruga Mukej	2019	60	50
Rikonstruksion rruga Udhakryq	2019	1000	400
Rikonstruksion rruga Cen Broja	2019	190	80
Rikonstruksion rruga Bahçallek	2019	480	300
Rikonstruksion degëzime rruga e "Shirokës"	2019	465	400
Rikonstruksion rruga "Vehbi Ismaili"	2019	225	110
Rikonstruksion rruga "Safet Hoxha"	2020-2021	135	120
Rikonstruksion degëzim rruga "Ibrahim Rugova"	2020-2021	70	50
Rikonstruksion Rruga "Daniel Mozali"	2020-2021	520	200
Rikonstruksion degëzim Rruga "Hamz Kazazi"	2020	115	130
Rikonstruksion Rruga "Rexhep Dizdari"	2020	100	120
Ndërtim trotuari rruga nacionale (rruga e Tiranës), Bahçallek	2020	1000	300
Rikonstruksion rrugë të brëndshme "Shirokë"	2020 - 2021	150	200
Në proces: Sistemim - asfaltim rruga "e Drinit" Bahçallek	2021 - 2023	300	70
Në proces: Rikonstruksion rruga "Freskej"	2021 - 2023	100	100
Total		6920	3520

Lagje 3

INFRASTRUKTURA RRUGORE	vitet e realizimit	ml / m2	banorë përfitues
Rikualifikim i blloqeve të banimit		m2	
Rikualifikim urban i bllokut të banimit "Qemal Draçini"; (Pallati me hark)	2016	2500	300
Rikualifikim urban i bllokut të banimit "Bardelej" (Pogej)	2016	1040	260
Rikualifikim urban i rrugëve në Qendrën Historike	2016-2018	10000	650
Rehabilitimi i sheshit "Gjon Pali"	2016	3000	20000
Rikualifikim urban i bllokut të banimit "Qemal Dracini" (tek Sahati)	2018-2019	3500	700
Në proces: Rikualifikim urban i bllokut të banimit "Bashkimi"	2021-2022	1000	200
Totali		21040	22110
RIKUALIFIKIM RRUGË DHE TROTUARE	vitet e realizimit	ml	banorë përfitues
Rikonstruksion rruga "Dhimitër Frangu"	2017	300	120
Rikonstruksion rruga "Pjetër Spani"	2017	1265	120
Rikonstruksion degëzime rruga "At Shtjefën Gjeçovi"	2019	100	400
Rikonstruksion rruga "Brioti"	2019	725	200
Rikonstruksion rruga "Lodërtune"	2018	400	180
Rikonstruksion degëzim rruga "At Gjergj Fishta"	2020	85	400
Rikonstruksion degëzim rruga "Gjon Shllaku"	2020	75	80
Rikonstruksion degëzim rruga "Marin Biçikemi"	2020	100	200
Rikonstruksion degëzim rruga "Pogej"	2020	50	50
Rikonstruksion rruga "Magjoni"	2020	580	200
Rikonstruksion rruga "Mehmet Shpendi"	2020	625	1200
Në proces: Rikonstruksion degëzim rruga "Pjetër Budi"	2021	160	120
Në proces: Rikonstruksion rruga "Karaçaj"	2021-2022	55	50
Në proces: Rikonstruksion degëzim rruga "Treni i Mallrave"	2021-2022	80	100
Në proces: Rikonstruksion rruga "Asdreni"	2021 - 2023	200	100
Në proces: Rikonstruksion degëzim rruga "Lin Delia"	2021-2023	220	250
Total		5020	3770

Lagjja 4

INFRASTRUKTURA RRUGORE	vitet e realizimit	ml / m2	banorë përfitues
Rikualifikim i blloqeve të banimit			
Rikonstruksion i bllokut të pallateve "Xhabije"	2017-2018	58940	5000
Rikonstruksion i bllokut të pallateve (ish Rajoni nr.4) Rruga "Bulevardi Skënderbeg"	2020-2022	2200	300
Rikonstruksion i bllokut të pallateve "Mehmet Pashë Plaku" (afër servis "Jubani")	2020-2021	2320	800
Rikonstruksion i bllokut të pallateve "Mehmet Pashë Plaku" (përballë Medreses)	2020-2021	800	800
Rikonstruksion i bllokut të pallateve "Mehmet Pashë Plaku" (përballë shkollës "Ali Laçej")	2020-2021	800	700
Në proces: Rikonstruksion i bllokut të pallateve ndërmjet Bulevardit "Mehmet Pashë Plaku" dhe rrugës "Baja Vogël"	2021-2022	1050	250
Në proces: Rikualifikim i bllokut urban, rruga Daut Boriçi.	2019-2021	1190	300
Total		67300	8150
RIKUALIFIKIM RRUGË DHE TROTUARE	vitet e realizimit	ml	banorë përfitues
Rikonstruksion degëzim i rrugës "Draçin"	2016	300	100
Rikonstruksion i rrugës "Draçin"	2017	280	50
Rikonstruksion i rrugës "Lugoçesme"	2018-2019	1000	600
Rikonstruksion i rrugës Hafiz Ali Ulqinaku faza I dhe II	2019-2021	200	110
Rikonstruksion degëzim i rrugës "Ymer Prizreni" faza I dhe II	2020-2021	260	120
Në proces: Rikonstruksion degëzim i rrugës "Qafë"	2021	130	50
Në proces: Rikonstruksion vazhdim i rrugës "Enver Draçini" dhe rruga e "Depos"	2021	450	100
Në proces: Rikonstruksion i rrugës "Bardhosh Dani" në lidhje me Rrugën "Rrojë"	2021 - 2023	250	200
Në proces: Rikonstruksion i rrugës "Milosao"	2021 - 2023	130	150
Në proces: Rikonstruksion i rrugës "Riza Dani"	2021 - 2023	90	80
Në proces: Rikonstruksion i rrugës pranë shkollës "Ali Laçej"	2021 - 2023	150	50
Në proces: Rikonstruksion i rrugës "Dragushej"	2022-2023	265	300
Në proces: Rikonstruksion vazhdim i rrugës "Ajasëm"	2021-2023	680	100
Në proces: Rikonstruksion i rrugës "9 Nuset"	2021-2023	630	120
Në proces: Rikonstruksion rruga Usta Meta	2021-2023	280	250
Në proces: Rikonstruksion i bllokut të pallateve "Arkitekt Sinani"	2021 - 2023	1460	100
Total		6555	2480

Lagjja 5

INFRASTRUKTURA RRUGORE	vitet e realizimit	m ² / m	banorë përfitues
Rikualifikim i blloqeve të banimit		m ²	
Rikualifikim urban i bllokut të banimit Tepe- ish fusha e druve	2017	5000	800
Rikualifikim urban i bllokut të banimit "Tepe" (tek Vasiejt)	2017	780	200
Rikualifikim urban i bllokut të banimit "Shtatë Shaljanët"	2020-2021	2535	600
Rikualifikim Urban Blloqe Banimi "Henrik Laca"	2019-2020	1000	650
Total		9315	2250
RIKUALIFIKIM RRUGË DHE TROTUARE		m	banorë përfitues
Rikonstruksion rruga "Qyteza e Gajtanit"	2017	400	180
Rikonstruksion rruga "Kamilo Libardi"	2019	240	90
Rikonstruksion rruga "Zef Kakarriqi"	2019	325	200
Rikonstruksion rruga "Vllaznimi"	2018	350	250
Rikonstruksion rruga "Shasi"	2019	420	180
Rikonstruksion rruga "Degrand"	2020	270	230
Rikonstruksion rruga "Imzot Zef Simoni"	2020	75	70
Rikonstruksion rruga Mehmet Shpendi	2020-2022	625	1200
Në proces: Rikonstruksion rruga "Degrand"	2020-2021	270	230
Në proces: Rikonstruksion rruga e "Martirëve"	2021	240	150
Në Proces: Rikonstruksion rruga e "Dalmacës"	2021-2022	360	200
Në Proces: Rikonstruksion rruga "Zhasin Hakard"	2021	170	100
Në Proces: Rikonstruksion rruga "Gjino Berri"	2021-2022	200	110
Në Proces: Rikonstruksion degëzim rruga "Besnik Ceka"	2021 - 2023	120	80
Në Proces: Rikonstruksion rruga (degëzim) "At Zef Valentini"	2021-2023	325	200
Në Proces: Rikonstruksion rruga "Milan Shuflaj"	2021-2023	430	1000
Në proces: Rikonstruksion rruga Qafa e Bishkazit	2021	1500	450
Në proces: Rikonstruksion rruga Don Nikollë Kaçorri	2021 - 2023	175	100
Në proces: Rikonstruksion rruga "Gjon Gazulli"	2022 -2023	370	150
Total		6865	5170

12. zgjerimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror për prindërit në nevojë

- Sa familje që jetojnë në bodrume apo shtëpi pa kushte minimale jetese kanë përfituar nga strehimi social apo/dhe bonusi i qerasë?
- Sa gra, viktime të dhunës në familje kanë përfituar strehim social apo / dhe bonus qeraje?
- Sa kredi të buta janë parashikuar që të shpërndahen

- Nga Familjet që kanë jetuar në banesa jashtë standarteve të përcaktuara në ligj, në rrezik shembje apo që nuk mund të kualifikohen si banesa janë 20 familje që kanë përfituar nga programet e strehimit social.

- Jane 8 gra viktime të dhunës në familje që kanë përfituar strehim social.

- Për bashkinë Shkoder janë planifikuar 100 kuota për programin e Subvencionimit të interesave të kredise,

13. Bashkia të ndërtojë mekanizma të unifikuar dhe efektive për të marrë këndvështrimin e komunitetit mbi vendimarrje të rëndësishme

- Cilat janë mënyrat e komunikimit që ka përdorur bashkia për të marrë këndvështrimin e qytetarëve mbi vendimarrjen e rëndësishme

Komuniteti rom dhe egjiptian, është ndër grupet më të varfra, më të marginalizuara dhe më të përjashtuara që jetojnë në të gjithë Shqipërinë, përfshi edhe në qytetin e Shkodrës.

Romët dhe egjiptianët përballen me pengesa direkte dhe indirekte në qasjen në shërbimet sociale, shëndetësore, publike, etj. Studimet tregojnë se niveli i varfërisë të këtij komuniteti është dy herë më i lartë sa shumica e popullsisë së vetë komunitetit.

Frekuentimi i ulët i shkollës dhe braktisjes shumë herët, pa përfunduar arsimin e detyruar, janë rezultat i nivelit të ulët arsimor dhe më konkretisht analfabetizmit dhe për pasojë edhe nivelit të ulët ekonomik të këtij komuniteti. Me qëllim përfshirjen e këtij komuniteti dhe lehtësimin e problematikave tyre në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit me partnerët janë realizuar ndërhyrjet e planifikuara me qëllim fuqizimin e komunitetit rom dhe egjiptian dhe krijimin e kushteve më të mira të jetesës për këtë komunitet, si dhe ka vazhduar ofrimi i shërbimeve sociale, integruese dhe mbështetëse pranë qendrës komunitare multifunktionale, për komunitetin rom dhe egjiptian.

Qendra multifunktionale për komunitetin rom dhe egjiptian është vënë në funksion të plotë dhe ofron shërbime specifike për komunitetin rom dhe egjiptian. Gjatë vitit 2020 -2021 janë ofruar shërbime sociale, integruese dhe mbështetëse për komunitetin rom dhe egjiptian ku përmendim; punësimin, kurse profesionale, identifikimi dhe regjistrimi në sistemin arsimor parashkollor dhe shkollor të të gjithë fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian, vizita mjekësore dhe trajtim mjekësor për fëmijët dhe gratë shtatzëna, regjistrimi i vendbanimit në gjendjen civile të Bashkisë së Shkodrës për familjet rome të interesuara dhe është ofruar mbështetje për çdo proçedurë administrative të nevojshme për këtë proces.

Gjithashtu bashkia shkodër po zbaton programin e strehimit social për permiresimin e kushteve të banimit të komunitetit rom ku të përfitojnë 27 familje të këtij komuniteti.

14. Programe dhe shërbime mbi adresimin e dhunës në familje

- A janë zgjeruar programet apo aktivitetet ndërjegjësuese sa i përket mospranimit të dhunës në asnjë formë?
- Si ka shkuar ecuria e numrit të identifikuar të rasteve dhe trajtimi i tyre
- Po në njësitë administrative a ekzistojnë qendra komunitare dhe a janë zgjeruar shërbimet mbrojtëse për viktimat e dhunës?

Bashkia e Shkodrës, gjatë viteve të fundit i ka kushtuar rëndësi të veçantë çështjeve gjinore dhe dhunës në familje, duke i integruar në të gjitha programet dhe funksionet e saj.

Në zbatim të ligjit nr.139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”; ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”(i ndryshuar) me Ligjin Nr.47/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për Masa ndaj Dhunës

në Marrëdhëniet Familjare”; si dhe të VKM nr. 334, datë 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”, i ndryshuar me VKM Nr.327, datë 02.06.2021:

Bashkia e Shkodrës ka koordinuar dhe nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit për riorganizimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij. Kjo marrëveshje është nënshkruar nga të gjitha institucionet publike që veprojnë në territorin e bashkisë së Shkodrës me rastet e dhunës në familje dhe gjithashtu organizatat e shoqërisë civile që janë aktive dhe veprojnë në territor me këtë target grup.

Bashkia e Shkodrës ka krijuar dhe vënë në funksion Qendrat Komunitare “Për Familjen”. Aktualisht janë në funksion 12 qendra; 7 në zonën urbane dhe 5 në njësitë administrative. Në këto qendra ofrohet informim, këshillim, orientim, mbrojtje e fëmijëve, shërbime për fëmijët dhe familjen, fuqizimi ekonomik, programe prindërimi, fuqizim komunitetit, ri-integrim në shkollë dhe mbështetje familjare për nevojat arsimore të fëmijëve, ofrohen shërbime për familjet në vështirësi socio-ekonomike, vulnerabël ndaj fenomenit të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe gjithashtu janë trajtuar dhe mbështetur viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, duke ofruar shërbime sipas nevojave specifike të secilit rast.

Në territorin e Bashkisë së Shkodrës që nga viti 2015 është krijuar dhe vënë në funksion strehëza për rastet emergjente të dhunës me bazë gjinore.

Gjatë vitit 2021 ka vazhduar ofrimi i shërbimeve për viktimat e dhunës në familje dhe konsolidimi i tyre.

Në krahasim me të njëjtën periudhë të viteve të mëparshme vihet re një rritje gati 2-fish e rasteve të dhunës në familje të pajisur me UMM ose UM. Për këtë arsye, Bashkia e Shkodrës në bashkëpunim me organizatat partnere Gruaja tek gruaja dhe Nisma/ Arsis ka rritur kapacitetet e ofrimit të shërbimit të emergjencës, duke rritur numrin e shtretërve dhe numrin e ditëve të qëndrimit në strehëz. Po në këtë kuadër është trajnuar dhe punësuar një staf i posacëm oncall për ofrimin e shërbimeve dhe menaxhimin e rasteve emergjente, i cili funksionon 24/24, 7 në 7.

Në bashkinë e Shkodrës operon dhe ushtron aktivitetin e saj edhe strehëza e përkohshme e Papa Xhovani XXIII, me të cilën bashkëpunimi në menaxhimin e rasteve ka qenë i vazhdueshëm.

Bashkia Shkodër tashmë ka të ngritur dhe funksionale edhe një qendër ditore që ofron shërbime me orare të zgjatura dhe në fundjavë, për fëmijët e rasteve të dhunës në familje, VMT apo VT. Aktualisht në këtë qendër marrim shërbim 7 fëmijë.

Me qëllim fuqizimin socio-ekonomik dhe riintegrimin e tyre në shoqëri për kategoritë vulnerabël si grate viktime të dhunës në familje janë parashikuar lehtësira në paketën fiskalë të Bashkisë Shkodër, duke i përjashtuar nga pagesa e çerdheve dhe kopshteve.

Bashkia e Shkodrës ka nënshkruar Kartën Evropiane në 8 Mars 2017, duke e bërë atë pjesë të dokumentave dhe instrumentave që orientojnë veprimet dhe hapat që ndërmerren në të gjitha aspektet e jetës: politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore. Menjëherë pas marrjes së këtij angazhimi publik, i gjithë stafi i Bashkisë Shkodër është angazhuar maksimalisht për zbatimin në praktikë të Kartës Evropiane.

Përveç përkushtimit për hartimin e Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2018-2020 për një periudhë relativisht të shkurtër kohore, Bashkia Shkodër caktoi në buxhetin e saj vjetor një zë dhe fonde përkatëse pikërisht për aktivitete për zbatimin e Kartës Evropiane.

Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore, mbulon një tërësi fushash dhe në të parashikohen veprime që synojnë: respektimin e të drejtës themelore të barazisë ndërmjet grave dhe burrave, vajzave dhe djemve; trajtimin e çështjeve të pabarazive dhe diskriminimit; veprime për eliminimin e stereotipeve gjinore; pjesëmarrjen e balancuar të grave dhe burrave në vendim-marrjen politike e publike; aksesin në shërbime të ndryshme të hartuara sipas nevojave të veçanta të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve, si dhe ofrimin e këtyre shërbimeve me cilësi e në respektim të parimeve të barazisë; integrimin e këndvështrimit gjinor në të gjitha planet dhe fushat për zhvillim të qëndrueshëm; planifikimin e mbështetur në burimet e duhura, etj.

Buxhetimi me pjesëmarrje – konsultimi i buxhetit të bashkisë për çdo program buxhetor; zhvillimi ekonomik, turizmi, investimet, shërbimet publike, shërbimet sociale, etj., me shoqërinë civile, komunitetin, biznesin dhe palë të interesuara.

Buxhetimi gjinor – proces që krijon një perspektivë gjinore në të gjitha nivelet e procesit buxhetor dhe ristrukturimit të të ardhurave dhe shpenzimeve me qëllim promovimin e barazisë gjinore.

Krijimi i apartamenteve sociale (ish konvikti pyjores) me destinacion jetimët që jetojnë në konvikte, jetimët që dalin nga strukturat rezidenciale dhe gratë kryefamiljare në situatë të vështirë socio-ekonomike.

Hapja e çerdheve dhe kopshteve të reja, në shërbim të komunitetit me qëllim krijimin e mundësive për punësim të grave dhe vajzave – nëna, duke ndihmuar në fuqizimin socio-ekonomik dhe riintegrimin në shoqëri të tyre.

Planifikimi i shërbimeve publike, është realizuar sipas qasjes gjinore; shërbime dhe investime që i përgjigjen njëlloj të dyja gjinive; mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane, prodhimi, trajtimi, transmetimi dhe furnizimi me ujë të pijshëm, shërbimi i dekorit

publik dhe ndriçimi i mjediseve publike duke ndikuar kështu drejtpërdrejtë në sigurinë e vajzave dhe grave, banore në territorin e Bashkisë së Shkodrës.

Të gjitha aktivitetet sensibilizuese që organizohen nga Bashkia e Shkodrës, në ditë ndërkombëtare (8 marsi-dita ndërkombëtare e gruas, 8 prilli-dita ndërkombëtare e romëve, 15 maj-dita ndërkombëtare e familjes, 1 qershor-dita kombëtare e fëmijëve, 1 tetor-dita e të moshuarve, 20 nëntor-dita ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 25 nëntor-10 dhjetor - 16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore, etj.) i kushtojnë vëmendje të veçantë qasjes gjinore dhe promovimit të rolit të gruas në shoqëri. Në 16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore, Bashkia e Shkodrës planifikon dhe zhvillon një sërë aktivitetesh sensibilizuese. Aktivitetet zhvillohen në bashkëpunim të ngushtë me partnerët e shoqërisë civile, institucionet publike dhe sigurisht median, me synim shpërndarjen e informacionit sa më gjerë. Organizime të veprimtarive ndërgjegjësuese, si; aktivitete me të rinjtë, forume diskutimi, takime me grupe vulnerabël ndaj fenomenit dhunë në familje, emisione në media, etj., zhvillohen përgjatë të gjithë vitit, por theksi dhe intensiteti i tyre është në 16 ditët e aktivizmit.

Organizatat e shoqërisë civile në bashkinë e Shkodrës luajnë një rol të rëndësishëm e pozitiv veçanërisht në funksionimin e mekanizmit të referimit si edhe ofrimin e shërbimeve si ndaj viktimave të dhunës në familje ashtu edhe ndaj personave të dënuar për dhunë në familje dhe dhunë me bazë gjinore.

Në vazhden e traditës së mirë të bashkëpunimit të vazhdueshëm me organizatat e shoqërisë civile Bashkia Shkodër ka bashkëpunuar ngushtë edhe me organizatat ndërkombëtare të tilla si: UNDP DHE UN WOMEN, si dhe organizata të tjera si: organizata Gruaja te Gruaja, Terre Des Hommes Albania, Hapat e Lehtë, Albanian Disability Rights Foundation, Papa Giovanni XXIII, World Vision, Nisma për ndryshim shoqëror, Hope for the Eorld, Gender Alliance for Development Center për çështjet e dhunës me bazë gjinore.

Në territorin e bashkisë së Shkodrës, përfaqësimi i grave në politikë e vendimmarrje ka pësuar një përmirësim të dukshëm; Bashkia e Shkodrës dhe Këshilli Bashkiak drejtohet nga një grua. Një ndër Nënkryetaret e Bashkisë Shkodër është grua. Këshilli Bashkiak ka 51 anëtarë nga të cilët 25 gra. Stafi i Bashkisë Shkodër - 55.1% janë gra dhe 44.9% janë meshkuj.

Në zbatim të VKM nr. 334, datë 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”, ndryshuar me VKM Nr. 327, date 02.06.2021, në Bashkinë e Shkodrës janë të ngritur dhe funksional:

1.Komiteti drejtues, i drejtuar nga Kryetarja e Bashkisë Shkodër dhe i përbërë nga drejtuesit e institucioneve dhe organizatave të shoqërisë civile që veprojnë në nivel vendor;

2. Ekipi teknik ndërdisiplinor i përbërë nga përfaqësues teknikë të institucioneve pjesë të komitetit drejtues;

3. Koordinator i vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, i cili është përfaqësues i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik.

ETN mblidhet ad-hoc, në varësi të rasteve të dhunës në familje dhe problematikave që paraqet çdo rast konkret, ose brenda 24-48 orëve, javës kur është identifikuar rasti. Ky ekip mblidhet me kërkesën e institucionit, pjesë e mekanizmit, i cili ka identifikuar rastin (psh; policia, organizata, Bashkia, qendrat komunitare). Në momentin që paraqitet një rast dhune, bëhet vlerësimi fillestar për të parë nivelin e riskut në të cilin ndodhet viktimja. Më pas bëhet vlerësimi i detajuar, sipas nevojave që paraqet rasti, mblidhet ETN, ndahen rolet e përgjegjësitë. Pas vlerësimit të nevojave të çdo rasti, hartohet plani i punës dhe për çdo shërbim të specializuar vlerësohen mundësitë dhe kapacitetet fillimisht nga institucionet, pjesë e mekanizmit dhe në rast se këto institucione nuk i ofrojnë, kërkohet mbështetja nga partnerë të ndryshëm privatë apo publikë.

Çdo rast, që trajtohet nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale e Bashkisë së Shkodrës, si dhe Qendrat Komunitare “Për Familjen”, pjesë e kësaj drejtorie, trajtohet në zbatim të plotë me legjislacionin përkatës.

Bashkia Shkodër përgjatë vitit 2020 dhe periudhës janar-shtator 2021 ka trajtuar, menaxhuar dhe monitoruar 221 raste të dhunës në familje. Për të gjithë rastet janë hartuar dhe dërguar raportet përkatëse të monitorimit çdo 60 ditë në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër.

Për çdo rast të personave të dhunuar ofrohen shërbime parashoqërore (informimi, orientimi, këshillimi, shërbime në familje, mbështetje psiko-sociale dhe ndërhyrje të hershme); shërbime komunitare (mbrojtja e fëmijëve, shërbime për fëmijën dhe familjen, fuqizim ekonomik, programe prindërimi, shërbime arsimore, lëvizëse, shërbime për higjienën personale, kujdesin shëndetësor); shërbime të strehimit emergjent dhe të përkohshme (strehëz për situatë emergjente dhe banesa sociale). Në varësi të nevojave specifike të rastit, ofrohen edhe shërbimet specifike për të cilat individit ka nevojë.

Në varësi të nevojave viktimat e dhunës në familje, kanë marrë mbështetjen e duhur psikologjike dhe ligjore nga stafi i Qendrave Komunitare “Për familjen” të Bashkisë Shkodër dhe organizatat partnere që ofrojnë të tilla shërbime në Bashkinë Shkodër, duke asistuar që në momentin e nxjerrjes së UMM-së apo UM-së, marrjen pjesë në seancat gjyqësore, përgatitjen e raporteve për vlerësimin e gjendjes social-ekonomike dhe hartimin e dërgimin e raporteve përkatëse të monitorimit çdo 60 ditë në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër etj.

Të gjithë rastet e dhunës në familje të pajisura me UM përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike. Specialistët pranë qendrave komunitare “Për Familjen” informojnë çdo rast të

pajisur me UM për pagesën që me ligj ju takon dhe orientojnë/ asistojnë për procedurën përkatëse që duhet të ndjekin për ta përfutuar atë.

Të gjitha rastet janë trajtuar nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale e Bashkisë së Shkodrës, si dhe Qendrat Komunitare “Për Familjen”, pjesë e kësaj drejtorie në bashkëpunim të ngushtë më disa nga aktorët kryesorë të MKR-së si: Policia Vendore e Policisë Shkodër, organizatat e shoqërisë civile (Gruaja tek gruaja, Shpresë për Botën etj.), Drejtoria Rajonale e Punësimit Shkodër dhe NJVKSH Shkodër, në zbatim të plotë me legjislacionin përkatës.

Në Bashkinë e Shkodrës funksionon “Zyra për Djem dhe Burra”, e cila ofron programe këshillimi, konsulence dhe rehabilitimi për dhunuesit. Përgjatë këtyre viteve ata kanë vazhduar ofrimin e shërbimeve të tyre nëpërmjet këshillimit psikologjik për dhunuesit, si dhe programet/ aktivitetet e tyre me të rinjtë, komunitetin, partner të tjerë për të ofruar ndihmën e tyre në integrimin e shërbimit për trajtimin e dhunuesve në MKR-në Shkodër.

Vlen për t’u theksuar edhe gjendja e jashtëzakonshme që kemi kaluar, e shkaktuar nga pandemia COVID-19, gjatë së cilës problematikat e dhunës në familje u shtuan edhe më shumë. Shembull i mirë i vazhdimin të ofrimit të shërbimeve ka qenë edhe këshillimi online/telefonik, si dhe hartimi i një manuali, të shkurtër dhe praktik, për t’iu ardhur në ndihmë, në veçanti të gjithë djemve dhe burrave që ndiheshin të pasigurt ndërkohë që ndodheshin në karantinim.

Në kuadër të ndërgjegjësimit të shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, Bashkia Shkodër ka realizuar një sërë aktivitete për ndërgjegjësimin e komunitetit në lidhje me dhunën me bazë gjinore gjatë kësaj periudhe. Janë planifikuar, organizuar dhe zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuë në kuadër të 8 marsit, ditës ndërkombëtare të gruas dhe në zbatim të kartës evropiane për barazi mes burrave dhe grave, të nënshkruar në vitin 2017, sipas një kalendari të paracaktuar. Janë organizuar aktivitete sensibilizuese, informuese, të shpërndara në Qendrat Komunitare “Për Familjen”, shkollat e Bashkisë Shkodër, Qendrën Rinore Atelie dhe institucionet kulturore të Bashkisë Shkodër si: Biblioteka “Marin Barleti”, Muzeu “Oso Kuka”, Teatri Migjeni, Galeria e Arteve etj. Aktivitetet janë zhvilluar si në qytet ashtu dhe në njësitë administrative. Janë zhvilluar me prezencë fizike, por edhe online, në respektim të masave për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19.

Krahas aktiviteteve, fushatat e komunikimit online me qëllim rritjen e informimit dhe sensibilizimit të komunitetit për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje janë organizuar vazhdimisht përgjatë të gjithë kësaj periudhe me anë të postimeve në mediat sociale të Bashkisë Shkodër dhe Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik. Përgjatë gjendjes së emergjencës së shkaktuar nga COVID-19 janë shpërndarë poste me informacionin e nevojshëm se ku mund të kërkohet ndihmë dhe kontaktet e nevojshme. Gjatë aktiviteteve verore të organizuara me fëmijët në qendrat komunitare “Për Familjen” është folur për format e ndryshme të dhunës

dhe mënyrat e raportimit të saj. Aktivitetet janë zhvilluar si në qytet ashtu dhe në njësitë administrative.

Në faqen e facebook-ut të Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik gjeni të publikuar edhe çdo aktivitet sensibilizues të organizuar nga Bashkia Shkodër për parandalimin e dhunës.

<https://www.facebook.com/Drejtoria-e-Sh%C3%ABrbimeve-Sociale-Strehimit-dhe-Sh%C3%ABndetit-Publik-Shkod%C3%ABr-207655856280284/>

Bazuar në sa mësipër, mund të themi se sot ka përpjekje të vetëdijshme dhe të vazhdueshme për menaxhimin sa më të mirë të rasteve të dhunës në familje nga të gjithë aktorët anëtarë të MKR-së, por rruga është e gjatë dhe jo e lehtë, gjithashtu ka përpjekje të vazhdueshme që të përvetësojmë qasje të reja në fusha të ndryshme si administratë, investime, procese politike dhe jetë publike në mënyrë që të fillojmë një ndryshim strukturor, që përkthehet në implementim konkret të objektivave të barazisë gjinore në nivel qeverie vendore.

15. Zbatimi i programeve që nxisin ri-integrimin dhe fuqizimin ekonomik të komunitetit rom dhe egjiptian

- A janë zhvilluar programe për ri-integrimin dhe fuqizimin ekonomik të komunitetit rom dhe egjiptian

16. kopshtet dhe çerdhet; rikonstruksioni i kopshteve dhe çerdheve ekzistuese në qytetin e shkodres

- Sa kopshte dhe çerdhe janë rikonstruktuar në qytet dhe njësite administrative
- A ka patur investime në ndërtimin e kopshteve të reja në qytet apo njësite administrative

Që nga viti 2015 me ndryshimet ligjore të reformës territoriale bashkia Shkodër menaxhon kopshtet dhe çerdhet e territorit të Bashkisë, përkatësisht 55 kopshte dhe 7 çerdhe, duke filluar nga mbështetja e personelit tek mirëmbajtja dhe menaxhimi i godinave. Garantimi i ambjentëve të përshtatshme dhe shërbimit të kujdestarisë sipas standarteve është parimi që ka shoqëruar punën tonë në mirëadministrimin e këtij sektori të Bashkisë. Sipas njësive administrative dhe lagjeve të qytetit gjeni si më poshtë një përmbledhje të investimeve të kryera në vite, ku përveç mirëmbajtjes së godinave (suvatime, meremetime, lysterje, riparime të rrjeteve hidrike e elektrike) që kryhen çdo vit sipas nevojave, ka pasur edhe ndërtim të ambienteve të reja ose rikonstruksione të godinave të vjetra duke dhënë një impakt të qënësishëm në përmirësimin e infrastrukturës së Kopshteve dhe çerdheve. Gjithashtu

ndërhyrje ka pasur vit pas vitit edhe për sa i përket reduktimit të ngrohjes me gaz si dhe furnizimit me paisje dhe materiale didaktike.

Ana e Malit

Kopshtet		
Mbështetja e personelit edukator dhe të shërbimit të sistemit parashkollor për 4 kopshte të Anës së Malit	2016-2020	115
Rikonstruksion i pjesshëm i Kopshtit "Oblikë".	2016-2020	30

Guri i Zi

KOPSHTET		Fëmijë
Financim i shërbimit për 4 kopshte: në Gurin e Zi, në Kuç, në Rrenc, në Vukatanë	çdo vit	120
Rikonstruksioni i kopshtit në fshatin Kuç.	2020	20

Rrethina

KOPSHTET		Fëmijë
Rikonstruksion i ambjenteve të shërbimit në kopshtin "Isa Jakupi"	2016	60
Rikonstruksion i ambjenteve të shërbimit në kopshtin "Badhaj"	2016	45
Rikonstruksion i pjesshëm i kopshtit "Haxhi Hajdari" Golem	2020	50
Kopshti "Zues" është parashikuar rikonstruksioni i ambjenteve të shërbimit.	2021	20
Financim i shërbimit për 9 kopshte të Nj.A Rrethina: Zues, Haxhi Hajdari, Hot i Ri, Shtoj i Ri, Shtoj i Vjetër, Bardhaj, Guci e Re, Tringë Smajlaj	çdo vit	290

Lagjja nr. 1

KOPSHTET		Fëmijë
Financim i shërbimit për 6 kopshtet e lagjes nr. 1	çdo vit	215
Rikonstruksion i kopshtit "Bep Tusha"	2021	80
Rikonstruksion i Kopshtit/Çerdhes "Ngjyrat"	2019	120
Në proces kopshte & çerdhe tek ish shkolla Veterinare	2020	

Lagjja nr. 2

KOPSHTET		Femije
Financim i shërbimit për 5 kopshtet e lagjes nr. 2	çdo vit	250
Krijimi i çerdhes "Fluturat"	2018	37 fëmijë

Lagjja nr. 3

Kopshtet		përfitues/fëmijë
Financim i shërbimit për 3 kopshtet e lagjes nr. 3	çdo vit	170
Kopsht/Çerdhe "Njomëzat"	2020	18

Lagjja nr. 4

KOPSHTET	vitet e realizimit	fëmijë
Financim i shërbimit për 4 kopshtet e lagjes nr. 4 : Ajasëm, 1 Qershori, Ali Laçej, Liria	çdo vit	155
Rikonstruksion, shtim kapaciteti për kopshtin "1 Qershori"	2020	55

Lagjja nr. 5

KOPSHTET		përfitues/fëmijë
Rifunksionalizim i Godinës shkollore "Edith Durham" me shërbime kopshti	2016	80
Financim i shërbimit për 3 kopshtet e lagjes nr. 5	çdo vit	200

Velipoje

KOPSHTET		Femije
Financim i shërbimit për 3 kopshtet: Nikollë Zagorjani, Gjergj Vatë Martini, Velipojë e Re		145

Postribe

KOPSHTET		Femije
Mbështetja e personelit edukator dhe të shërbimit të sistemit parashkollor për 5 kopshte të Postribës: Postribë, Myselim, Kullaj, Dragoç, Drisht	çdo vit	150

Dajç

KOPSHTET		Femije
Financim i shërbimit për 2 kopshte: Shirq, Pentar	çdo vit	45

Bërdicë

KOPSHTET		Fëmijë
Financim i shërbimit për 3 kopshte: Trush, Bërdicë e madhe, Bërdicë e vogël	çdo vit	97

17. Marrja e masave parandaluese ndaj zjarreve ne njesite administrative Berdice dhe Dajc

• Cilat janë masat e marra për parandalimin e zjarreve ne njesitë administrative

Në ligjin Nr. 139/2015 “PËR VETËQEVERISJEN VENDORE”, Neni 29, “Funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike”, pika 2, parashikon “Garantimin e shërbimit të zjarrfikësve, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj” sipas këtij ligji, ky funksion i kaloi Bashkisë së Shkodrës Që me datë 19.01.2016 ,për realizimin e shërbimit te zjarrfikësve,përvec strukturës së brendshme të Bashkisë së Shkodrës, që ndjek politikat vendore për këtë veprimtari, do të funksionojë edhe Institucioni i varësisë “Drejtoria e emergjencave civile, mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, Institucion i cili me Urdhër të kryetarit të Bashkisë Shkodër, datë 19.06. 2017, ristrukturohet

me se miri ,si “Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi”. Numri i punonjësve në këtë institucion është 36 punonjës. Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, në vijim shërbimi i MNZSH-së, është strukturë e specializuar e gatishmërisë së përhershme. Misioni i këtij shërbimi është inspektimi, parandalimi, me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrja

për shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkaktuara nga dora e njeriut (LIGJ Nr. 152/2015 Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, neni 2) Po sipas këtij ligji, në Nenin 7, Organizimi i strukturës së shërbimit, pikat 3. Drejtoria ose sektori i shërbimit të MZSH-së në nivel vendor është në varësi të kryetarit të bashkisë. Ajo përfaqëson strukturën bazë operuese dhe inspektuese në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në territorin që ka në juridiksion. Çdo bashki duhet të mbulojë territorin e saj me shërbim zjarrfikës, me stacione të kompletuara me personel, automjete dhe pajisje zjarrfikëse Stacioni i shërbimit të MZSH-së është njësi operuese dhe inspektuese në varësi të drejtorit të MZSH-së dhe ngrihet në çdo bashki, duke zbatuar standardin 1 zjarrfikës profesionist për 1500-2000 banorë. Në propozicion me numër popullsie mbi 200 mijë banorë, dhe vetëm 35 punonjës aktual të stacionit, kemi raportin 1 punonjës për 6 000 qytetarë, pra 3 here më pak. Prandaj na lind detyrimi të shtojmë gradualisht, vit pas vitin nga 15 punonjës të stafit, deri në plotësim të kriterit të këtij ligji. Dhe me plotësimin e numrit duhet të ngrihen dhe 2 stacione të tjera Zjarrfikësesh, njëri në zonën e NënShkodrës (Velipojë ose Trush) dhe tjetri në zonën e MbiShkodrës (Njësia administrative Mes), me efektimin e plotësuar, në mënyrë që të jemi sa më parë qytetarëve. Sektori i Financës dhe shërbimeve mbështetëse dhe sektori i inspektimit parandalimit të MZSH-së kanë mundësi në pajisje TIK. Prandaj del e nevojshme blerja e 3 kompjuterave dhe 1 printer multifunksional për të plotësuar këto nevoja.

Në Nenin 9, Kryetari i bashkisë ka këto përgjegjësi:

a) merr masa për ngritjen dhe kompletimin me mjete e pajisje të stacioneve për fikjen e zjarreve dhe shpëtimin, të shërbimit të MZSH-së në territorin e bashkisë, sipas standardeve e normave në fuqi;

b) planifikon fondet e shërbimit të MZSH-së, nga buxheti i bashkisë, për çdo vit.

Në llogarinë Transferime korentë do të trajtohen disa punonjës, të cilët në zbatim të VKM 499 datë 13.08.1998i ndryshuar me VKM 633 datë 28.10.1998, përfitojnë shpërblim për perballimin e ngarkesës familjare mbi 3 fëmijë.

KRYETAR

Voltana Ademi